



Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrotjen e Konkurrencës neni 6 paragrafi (2) dhe neni 26 paragrafi (1) nën paragrafi (1.1), në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2023, miraton:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 06/2023 PËR PËRJASHTIM
GRUPOR TË MARRËVESHJEVE VERTIKALE TË NDËRMARRJEVE**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ përcakton kushtet që duhet të përbajnë marrëveshjet vertikale ndërmjet ndërmarrjeve, si dhe kushtet që nuk duhet të përbajnë këto marrëveshje, për t'u përjashtuar nga ndalesa e përgjithshme e nenit 5 të Ligjit pér mbrotjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

**Neni 2
Përkufizimet**

1. Për qëllimet e këtij Udhëzimi Administrativ do të zbatohen përkufizimet në vijim:
 - a) ‘**marrëveshje vertikale**’ do të thotë një marrëveshje ose praktikë e bashkërenduar ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, secila prej të cilave operon, pér qëllimet e marrëveshjes ose praktikës së bashkërenduar, në një nivel të ndryshëm të zinxhirit të prodhimit ose shpërndarjes, dhe në lidhje me kushtet në të cilat palët mund të blejnë, shesin ose rishesin mallra ose shërbime të caktuara;
 - (b) ‘**kufizimet vertikale**’ do të thotë kufizimi i konkurrencës në një marrëveshje vertikale që bie brenda fushëveprimit të nenit 5 të ligjit;
 - (c) ‘**ndërmarrje konkuruese**’ do të thotë një konkurrent aktual ose i mundshëm;
 - (d) ‘**konkurrent aktual**’ do të thotë një ndërmarrje që është aktive në të njëjtin treg përkatës;
 - (e) ‘**Konkurrent i mundshëm**’ do të thotë një ndërmarrje që, në mungesë të marrëveshjes vertikale, do të kishte gjasa që, mbi baza reale dhe jo veçse mbi një mundësi të thjeshtë teorike, të bënte investimet e nevojshme shtesë brenda një periudhe të shkurtër kohore ose pér të bënte kostot tjera të nevojshme pér të hyrë në tregun përkatës;
 - (f) ‘**furnizuesi**’ përfshin një ndërmarrje që ofron shërbime ndërmjetësimi online;
 - (g) ‘**shërbime ndërmjetësimi në internet**’ do të thotë çdo shërbim i ofruar normalisht kundrejt shpërblimit, në distancë, me anë të mjeteve elektronike dhe me kërkësë individuale të një marrësi shërbimesh, të cilat u lejojnë ndërmarrjeve të ofrojnë mallra ose shërbime: (I) ndërmarrjeve të tjera, me synimin pér të lehtësuar fillimin e transaksioneve të drejtpërdrejta ndërmjet këtyre ndërmarrjeve, ose (II) konsumatorëve fundorë, me synimin pér të lehtësuar fillimin e transaksioneve të drejtpërdrejta ndërmjet këtyre ndërmarrjeve dhe konsumatorëve fundorë, pavarësisht nëse janë kryer dhe ku janë kryer transaksionet përfundimisht. Pér qëllimet e këtij përkufizimi: ‘**në distancë**’ do të thotë që shërbimi ofrohet pa qenë të pranishëm palët në të njëjtën kohë; ‘**me anë të mjeteve elektronike**’ do të thotë që shërbimi dërgohet fillimisht dhe merret në destinacionin e tij me anë të pajisjeve elektronike pér përpunimin (përfshirë kompresimin dixhital) dhe ruajtjen e të dhënavë, dhe tërësisht

transmetohet, përcillet dhe merret me tel, me radio, me mjete optike ose me mjete të tjera elektromagnetike; ‘**me kërkesë individuale të një marrësi të shërbimeve**’ do të thotë që shërbimi ofrohet nëpërmjet transmetimit të të dhënave me kërkesë individuale;

(h) ‘**Detyrimi për të mos konkurruar**’ do të thotë çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që e bën blerësin të mos prodhojë, blejë, shesë ose rishesë mallra ose shërbime që konkurrojnë me mallrat ose shërbimet e kontratës, ose çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë ndaj blerësit për të blerë nga furnizuesi ose nga ndonjë ndërmarrje tjetër të caktuar nga furnizuesi më shumë se 80% të blerjeve totale të blerësit të mallrave ose shërbimeve të kontratës dhe zëvendësuesve të tyre në tregun përkatës, të llogaritura në bazë të vlerës ose, kur kjo është praktikë standarde industrisë, në bazë të vëllimit të blerjeve të saj në vitin kalendarik paraardhës;

(i) ‘**Sistemi i shpërndarjes selektive**’ do të thotë një sistem shpërndarjeje ku furnizuesi merr përsipër t'i shesë mallrat ose shërbimet e kontratës, drejtpërdrejt ose tërthorazi, vetëm shpërndarësve të përgjedhur në bazë të kritereve të specifikuara dhe ku këta shpërndarës marrin përsipër të mos ua shesin mallrat ose shërbimet e tillë shpërndarësve të paautorizuar brenda territorit të rezervuar nga furnizuesi për të operuar atë sistem;

(j) ‘**Sistemi i shpërndarjes ekskluzive**’ do të thotë një sistem shpërndarjeje ku furnizuesi cakton një territor ose grup klientësh ekskluzivisht për vete ose për një maksimum prej pesë blerësve dhe i kufizon të gjithë blerësit e tjerë të tij që të shesin në mënyrë aktive në territorin ekskluziv ose grupit ekskluziv të klientëve;

(k) ‘**të drejtat e pronësisë intelektuale**’ do të përfshijnë të drejtat e pronësisë industriale, njoburitë, të drejtat e autorit dhe të drejtat fqinje;

(l) ‘**know-how (njoburitë teknike)**’ do të thotë një paketë informacioni praktik të patentuar, që rezulton nga përvoja dhe testimi nga furnizuesi, i cili është sekret, thelbësor dhe i identifikuar. Për qëllime të këtij përkufizimi: ‘**sekret**’ do të thotë që njoburitë teknike nuk janë përgjithësisht të njobura ose lehtësish të qasshme; ‘**thelbësor**’ do të thotë se njoburitë janë të rëndësishme dhe të dobishme për blerësin për përdorimin, shitjen ose rishitjen e mallrave ose shërbimeve të kontratës; ‘**i identifikuar**’ do të thotë që njoburitë pëershkuhen në një mënyrë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të bëjnë të mundur verifikimin nëse ato përbushin kriteret e fshehtësisë dhe të thelbësore;

(m) ‘**blerësi**’ do të përfshijë një ndërmarrje e cila, sipas një marrëveshjeje që bie në kuadër të nenit 5 të ligjit, shet mallra ose shërbime në emër të një ndërmarrjeje tjetër;

(n) ‘**shitjet aktive**’ do të thotë shënjestrim aktiv i klientëve nëpërmjet vizitave, letrave, emaileve, thirrjeve ose mjeteve të tjera të komunikimit të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet reklamimit dhe promovimit të synuar, offline ose online, për shembull me anë të mediave të shkruara ose dixhitale, duke përfshirë mediat online, shërbimet e krahasimit të çmimeve ose reklamat në motorët e kërkimit që synojnë klientët në territore të veçanta ose grupe klientësh, operimi i një faqeje interneti me një domen të nivelit të lartë që korrespondon me territore të veçanta, ose ofrimi në gjuhën e një faqeje interneti që përdoret zakonisht në territore të veçanta, ku gjuhë të tillë janë të ndryshme nga ato që përdoren zakonisht në territorin në të cilin është vendosur blerësi;

(o) ‘**shitjet pasive**’ do të thotë shitjet e bëra në përgjigje të kërkesave spontane nga klientët individualë, duke përfshirë shpërndarjen e mallrave ose shërbimeve tek klienti, ku shitja nuk është iniciuar duke synuar në mënyrë aktive klientin, grupin ose territorin e klientëve të caktuar, dhe duke përfshirë shitjet që rezultojnë nga pjesëmarrja në prokurimin publik ose përgjigjja ndaj ftesave private për tender.

2. Për qëllime të këtij Udhëzimi Administrativ, fjalët ‘*ndërmarrje*’, ‘*furnizues*’ dhe ‘*blerës*’ do të përfshijnë ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura.

‘**Ndërmarrjet e lidhura**’ do të thotë:

(a) ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshje, drejtpërdrejt ose tërthorazi:

ka fuqinë për të ushtruar më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose ka fuqinë për të emëruar më shumë se gjysmën e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen, ose ka të drejtë të menaxhojë punët e ndërmarrjes; ose

(b) ndërmarrjet të cilat drejtpërdrejt ose têrthorazi kanë, mbi një palë në marrëveshje, të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën (a); ose

(c) ndërmarrjet në të cilat një ndërmarrje e përmendur në pikën (b) ka, drejtpërdrejt ose têrthorazi, të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën (a); ose

(d) ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshje së bashku me një ose më shumë nga ndërmarrjet e përmendura në pikat (a), (b) ose (c), ose në të cilat dy ose më shumë nga ndërmarrjet nga pika e fundit, kanë së bashku të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën (a); ose

(e) ndërmarrjet në të cilat të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën (a) mbahen bashkërisht nga:

palët në marrëveshje ose ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura të përmendura nga pika (a) deri në pikën (d), ose

një ose më shumë nga palët në marrëveshje ose një ose më shumë nga ndërmarrjet e tyre të lidhura të përmendura në pikat (a) deri (d) dhe një ose më shumë palë të treta.

Neni 3 Përjashtimi

1. Në pajtim me nenin 5.2 të Ligjit dhe duke iu nënshtruar dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ, neni 5.1 i Ligjit nuk zbatohet për marrëveshjet vertikale. Ky përjashtim do të zbatohet për aq sa këto marrëveshje përbajnjë kufizime vertikale.
2. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 1 do të zbatohet për marrëveshjet vertikale të lidhura ndërmjet një shoqate ndërmarrjesh dhe një anëtar individual, ose ndërmjet një shoqate të tillë dhe një furnizuesi individual, vetëm nëse të gjithë anëtarët e shoqatës janë shitës me pakicë të mallrave dhe nëse asnjë anëtar individual i shoqatës, së bashku me ndërmarrjet e lidhura me të, nuk ka një qarkullim të përgjithshëm vjetor që i tejkalon 500,000 Euro. Marrëveshjet vertikale të lidhura nga shoqatat e tillë do të mbulohen me këtë Udhëzim Administrativ pa paragjykuar zbatimin e nenit 5 të Ligjit për marrëveshjet horizontale të lidhura ndërmjet anëtarëve të shoqatës ose vendimet e miratuara nga shoqata.
3. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 1 do të zbatohet për marrëveshjet vertikale që përbajnjë dispozita që kanë të bëjnë me dhënien blerësit, ose përdorimin nga blerësi, të të drejtave të pronësisë intelektuale, me kusht që këto dispozita të mos përbëjnë objektin kryesor të këtyre marrëveshjeve dhe të jenë drejtpërdrejt lidhur me përdorimin, shitjen ose rishitet e mallrave ose shërbimeve nga blerësi ose klientët e tij. Përjashtimi zbatohet me kusht që, në lidhje me mallrat ose shërbimet e kontratës, këto dispozita të mos përbajnjë kufizime të konkurrencës që kanë të njëjtin objekt sikurse kufizimet vertikale të cilat nuk janë të përjashtuara sipas këtij Udhëzimi Administrativ.
4. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 1 nuk zbatohet për marrëveshjet vertikale të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve konkuruese. Megjithatë, ky përjashtim do të zbatohet kur ndërmarrjet konkuruese hyjnë në një marrëveshje vertikale jo reciproke dhe zbatohet një nga pikat në vijim:
 - (a) furnizuesi është aktiv në një nivel të sipërm si prodhues, importues ose tregtar me shumicë dhe në nivelin e poshtëm si importues, shitës me shumicë ose pakicë i mallrave, ndërsa blerësi është një importues, shitës me shumicë ose shitës me pakicë në nivelin e poshtëm dhe jo një ndërmarrje konkuruese në nivelin e sipërm ku blen mallrat e kontratës; ose

(b) furnizuesi është një ofrues i shërbimeve në disa nivele të tregtisë, ndërsa blerësi ofron shërbimet e tij në nivelin e shitjes me pakicë dhe nuk është një ndërmarrje konkuruese në nivelin e tregtisë ku blen shërbimet e kontratës.

5. Përjashtimet e përcaktuara në paragrin 4, pikat (a) dhe (b) nuk do të zbatohen për shkëmbimin e të informacionit ndërmjet furnizuesit dhe blerësit i cili ose nuk lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e marrëveshjes vertikale ose nuk është i nevojshëm për të përmirësuar prodhimin ose shpërndarjen e mallrave ose shërbimeve të kontratës, ose i cili nuk i përbush asnjërin nga këto dy kushte.

6. Përjashtimet e përcaktuara në paragrin 4, pikat (a) dhe (b) nuk do të zbatohen për marrëveshjet vertikale në lidhje me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit online, ku ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online është një ndërmarrje konkuruese në tregun përkatës për shitjen e mallrave ose shërbimeve të ndërmjetësuara.

7. Ky Udhëzim Administrativ nuk do të zbatohet për marrëveshjet vertikale, çështja e të cilave bie brenda objektin e çdo udhëzimi tjetër administrativ për përjashtimin në bllok, përveç nëse parashikohet ndryshe në një udhëzim të tillë administrativ.

Neni 4

Pragu i pjesëmarrjes në treg

1. Përjashtimi i parashikuar në nenin 2 do të zbatohet me kusht që pjesëmarrja (pjesë) në treg që zotërohet nga furnizuesi të mos kalojë 30% të tregut përkatës në të cilin ai shet mallrat ose shërbimet e kontratës dhe pjesëmarrja në treg që zotërohet nga blerësi të mos i kalojë 30% të tregut përkatës në të cilin blen mallrat ose shërbimet e kontratës.

2. Për qëllimet e paragrit 1, kur në një marrëveshje shumëpalëshe një ndërmarrje blen mallrat ose shërbimet e kontratës nga një ndërmarrje që është palë në marrëveshje dhe ia shet mallrat ose shërbimet e kontratës një ndërmarrje tjetër që është gjithashtu palë në marrëveshje, pjesëmarrja në treg e ndërmarrjes së parë duhet të respektojë pragun e pjesëmarrjes në treg të parashikuar në atë paragraf si blerësi ashtu edhe si furnizues në mënyrë që të zbatohet përjashtimi i parashikuar në nenin 2.

Neni 5

Kufizimet që e heqin përfitimin nga përjashtimi në grup - kufizimet e rënda

Përjashtimi i parashikuar në nenin 2 nuk zbatohet për marrëveshjet vertikale të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të izoluara ose në kombinim me faktorë të tjera nën kontrollin e palëve, kanë si objekt:

(a) kufizimin e aftësisë së blerësit për të përcaktuar çmimin e tij të shitjes, pa paragjykuar mundësinë e furnitorit për të vendosur një çmim maksimal shitjeje ose për të rekonduar një çmim shitje, me kusht që ato të mos arrijnë në një çmim të fiksuar ose minimal shitjeje si një rezultat i presionit, ose i stimujve të ofruar, nga ndonjëra prej palëve;

(b) kur furnizuesi operon një sistem shpërndarjeje ekskluzive, kufizimin e territorit në të cilin, ose e klientëve të cilëve, shpërndarësi ekskluziv mund t'u shesë aktivisht ose pasivisht mallrat ose shërbimet e kontratës, përveç:

kufizimin e shitjeve aktive nga shpërndarësi ekskluziv dhe klientët e tij të drejtpërdrejtë, në një territor ose në një grup klientësh të rezervuar për furnizuesin ose të ndarë nga furnizuesi ekskluzivisht për një maksimum prej pesë shpërndarësve të tjera ekskluzivë;

kufizimin e shitjeve aktive ose pasive nga shpërndarësi ekskluziv dhe klientët e tij ndaj shpërndarësve të paautorizuar të vendosur në një territor ku furnizuesi operon një sistem të shpërndarjes selektive për mallrat ose shërbimet e kontratës;

kufizimin e vendit të themelimit të shpërndarësit ekskluziv;

kufizimin e shitjeve aktive ose pasive për përdoruesit fundorë nga një shpërndarës ekskluziv që operon në nivelin e tregtisë me shumicë;

kufizimin e aftësisë së shpérndarësit ekskluziv për të shitur në mënyrë aktive ose pasive komponentë, të furnizuar për qëllime të inkorporimit, për klientët që do t'i përdornin ato për të prodhuar të njëtin lloj mallrash si ato të prodhuara nga furnizuesi;

(c) kur furnizuesi operon një sistem shpérndarjeje selektive,

kufizimin e territorit në të cilin, ose të klientëve të cilëve, anëtarët e sistemit të shpérndarjes selektive mund të shesin në mënyrë aktive ose pasive mallrat ose shërbimet e kontratës, me përjashtim të:

kufizimit të shitjeve aktive nga anëtarët e sistemit të shpérndarjes selektive dhe klientët e tyre të drejtpërdrejtë, në një territor ose një grupi klientësh të rezervuar për furnizuesin ose të ndarë nga furnizuesi ekskluzivisht për një maksimum prej pesë shpérndarësve ekskluzivë;

kufizimit të shitjeve aktive ose pasive nga anëtarët e sistemit të shpérndarjes selektive dhe klientët e tyre ndaj shpérndarësve të paautorizuar që ndodhen brenda territorit ku funksionon sistemi i shpérndarjes selektive;

kufizimit të vendit të themelimit të anëtarëve të sistemit të shpérndarjes selektive;

kufizimit të shitjeve aktive ose pasive për përdoruesit fundorë nga anëtarët e sistemit të shpérndarjes selektive që vepron në nivelin e tregtisë me shumicë;

kufizimit të aftësisë për të shitur në mënyrë aktive ose pasive komponentë, të furnizuar për qëllime inkorporimi, për klientët që do t'i përdornin ato për të prodhuar të njëtin lloj mallrash si ato të prodhuara nga furnizuesi;

kufizimin e furnizimeve të kryqëzuara ndërmjet anëtarëve të sistemit selektiv të shpérndarjes që operojnë në të njëjtat ose nivele, ose në nivele të ndryshme tregtie;

kufizimin e shitjeve aktive ose pasive për përdoruesit fundorë nga anëtarët e sistemit të shpérndarjes selektive që operojnë në nivelin e tregtisë me pakicë, pa paragjykuar pikat (c) (i) (1) dhe (3);

(d) kur furnizuesi nuk operon as një sistem shpérndarjeje ekskluzive dhe as një sistem shpérndarjeje selektive, kufizimin e territorit në të cilin, ose të klientëve të cilëve, blerësi mund t'u shesë aktivisht ose pasivisht mallrat ose shërbimet e kontratës, përvçe;

kufizimit të shitjeve aktive nga blerësi dhe klientët e tij të drejtpërdrejtë në një territor ose për një grup klientësh të rezervuar për furnizuesin ose të ndarë nga furnizuesi ekskluzivisht për një maksimum prej pesë shpérndarësve ekskluzivë;

kufizimit të shitjeve aktive ose pasive nga blerësi dhe klientët e tij ndaj shpérndarësve të paautorizuar të vendosur në një territor ku furnizuesi operon një sistem shpérndarjeje selektive për mallrat ose shërbimet e kontratës;

kufizimit të vendit të themelimit të blerësit;

kufizimit të shitjeve aktive ose pasive për përdoruesit fundorë nga një blerës që operon në nivelin e tregtisë me shumicë;

kufizimit të aftësisë së blerësit për të shitur në mënyrë aktive ose pasive komponentë, të furnizuar për qëllime inkorporimi, për klientët që do t'i përdornin ato për të prodhuar të njëtin lloj mallrash si ato të prodhuara nga furnizuesi;

(e) parandalimin e përdorimit efektiv të internetit nga blerësi ose klientët e tij për të shitur mallrat ose shërbimet e kontratës, sepse kufizon territorin në të cilin, ose klientët të cilëve, mallrat ose shërbimet e kontratës mund t'u shiten sipas kuptimit të pikave (b), (c) ose (d), pa paragjykuar mundësinë e imponimit ndaj blerësit të:

kufizimeve të tjera të shitjeve online; ose

kufizimeve të reklamimit në internet që nuk kanë për qëllim parandalimin e përdorimit të një kanali të tërë reklamimi në internet;

(f) kufizimin, e rënë dakord midis një furnizuesi të komponentëve dhe një blerësi që inkorporon këta komponentë, të aftësisë së furnizuesit për t'i shitur komponentët si pjesë këmbimi për përdoruesit fundorë ose riparuesit, shitësit me shumicë ose ofruesit e tjerë të shërbimit që nuk u është besuar nga blerësi riparimi ose servisimi i mallrave të tij.

Neni 6

Kufizimet e përjashtuara

1. Përjashtimi i parashikuar në nenin 2 nuk zbatohet për detyrimet e mëposhtme të përfshira në marrëveshjet vertikale:

- (a) çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë për mos-konkurrim, kohëzgjatja e të cilit është e pacaktuar ose i kalon 5 vjet;
- (b) çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i cili bën që blerësi, pas përfundimit të marrëveshjes, të mos prodhojë, blejë, shesë ose rishesë mallra ose shërbime;
- (c) çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i cili bën që anëtarët e një sistemi shpérndarjeje selektive të mos shesin markat e furnitorëve të veçantë konkurrues;
- (d) çdo detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i cili bën që një blerës i shërbimeve të ndërmjetësimit në internet të mos ofrojë, shesë ose rishesë mallra ose shërbime për përdoruesit fundorë në kushte më të favorshme përmes shërbimeve konkurruese të ndërmjetësimit online.

2. Pavarësisht (duke deroguar) nga paragrafi 1, pika (a), kufizimi kohor prej pesë vitesh nuk do të zbatohet kur mallrat ose shërbimet e kontratës shiten nga blerësi përmes lokaleve dhe tokave në pronësi të furnizuesit ose të dhëna me qira nga furnizuesi nga palët e treta që nuk janë të lidhura me blerësin, me kusht që kohëzgjatja e detyrimit për mos-konkurrim të mos e kalojë periudhën e përdorimit të lokaleve dhe tokës nga blerësi.

3. Pavarësisht (duke deroguar) nga paragrafi 1, pika (b), përjashtimi i parashikuar në nenin 2 do të zbatohet për çdo detyrim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i cili bën që blerësi, pas përfundimit të marrëveshjes, të mos prodhojë, blejë, shesë ose rishesë mallra ose shërbime kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- (a) detyrimi lidhet me mallrat ose shërbimet që konkurrojnë me mallrat ose shërbimet e kontratës;
- (b) detyrimi kufizohet në ambientet dhe tokën nga e cila blerësi ka operuar gjatë periudhës së kontratës;
- (c) detyrimi është i domosdoshëm për të mbrojtur “know-how” (njojuritë teknike) të transferuara nga furnizuesi te blerësi; dhe
- (d) kohëzgjatja e detyrimit është e kufizuar në një periudhë prej një viti pas përfundimit të marrëveshjes.

Paragrafi 1, pika (b) nuk cenon mundësinë e vendosjes së një kufizimi të pakufizuar në kohë për përdorimin dhe zbulimin e njojurive që nuk kanë hyrë në domenin publik.

Neni 7

Tërheqja në raste individuale

Autoriteti i Konkurrencës mund ta tërheqë përfitimini nga ky Udhëzim Administrativ, në pajtim me nenin 6 të Ligjit, kur në ndonjë rast të veçantë konstaton se marrëveshja vertikale për të cilën zbatohet përjashtimi i parashikuar në nenin 2 të këtij Udhëzimi Administrativ ka, megjithatë, efekte të cilat janë të papajtueshme me nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit. Efekte të tilla mund të ndodhin, për shembull, kur tregu përkatës për furnizimin e shërbimeve të ndërmjetësimit në internet është shumë i përqendruar dhe konkurenca midis ofruesve të shërbimeve të tillë është e kufizuar nga efekti kumulativ i rrjeteve paralele të marrëveshjeve të ngjashme që kufizojnë blerësit e shërbimeve të ndërmjetësimit online në ofrimin, shitjen ose rishitet e mallrave ose shërbimeve për përdoruesit fundorë në kushte më të favorshme në kanalet e tyre të drejtpërdrejta të shitjes.

Neni 8

Zbatimi i pragut të pjesëmarrjes në treg

Për qëllime të zbatimit të kufijve të pjesëmarrjes (pjesës) në treg të parashikuar në nenin 3, zbatohen rregullat e mëposhtme:

- (a) pjesëmarrja në treg e furnizuesit do të llogaritet në bazë të dhënave të vlerës së shitjeve në treg dhe pjesëmarrja në treg e blerësit do të llogaritet në bazë të dhënave të vlerës së blerjeve në treg. Nëse të dhënat e vlerës së shitjeve në treg ose të vlerës së blerjeve në treg nuk janë të disponueshme, për të përcaktuar pjesëmarrjen në treg të ndërmarrjes në fjalë mund të përdoren vlerësimet e bazuara në informacione të tjera të besueshme në treg, duke përfshirë vëllimet e shitjeve dhe blerjeve në treg;
- (b) pjesëmarrja në treg do të llogariten në bazë të dhënave që kanë të bëjnë me vitin kalendarik paraardhës;
- (c) pjesëmarrja në treg e furnizuesit do të përfshijë çdo mall ose shërbim të ofruar për shpërndarësit e integruar vertikalish për qëllime të shitjes;
- (d) nëse një pjesëmarrje në treg fillimisht nuk është më shumë se 30%, por më pas rritet mbi atë nivel, përjashtimi i parashikuar në nenin 2 do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej dy vitesh kalendarik radhazi pas vitit në të cilin pragu prej 30% është tejkaluar fillimisht;
- (e) pjesëmarrja në treg e zotëruar nga ndërmarrjet e përmendura në nenin 1 (2), nën-paragrafi i dytë, pika (e) do t'i caktohet në mënyrë të barabartë secilës ndërmarrje që ka të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën (a) të atij nën-parografi.

Neni 9

Zbatimi i pragut të qarkullimit

1. Për qëllimin e llogaritjes së qarkullimit të përgjithshëm vjetor sipas kuptimit të nenit 2 (2), qarkullimi i realizuar gjatë vitit finanziar të mëparshëm nga pala përkatëse në marrëveshjen vertikale dhe qarkullimi i arritur nga ndërmarrjet e lidhura me të në lidhje me të gjitha mallrat dhe shërbimet, duke përjashtuar të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera, do të mblidhen së bashku. Për këtë qëllim, nuk do të merren parasysh marrëdhënet ndërmjet palës në marrëveshjen vertikale dhe ndërmarrjeve të lidhura me të ose ato ndërmjet ndërmarrjeve të lidhura me të.
2. Përjashtimi i parashikuar në nenin 2 do të mbetet i zbatueshëm kur, për çdo periudhë prej dy vitesh financiare të njëpasnjëshme, pragu total i qarkullimit vjetor tejkalohet me jo më shumë se 10%.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Neime Binaku-Isufi

Kryetare e Autoritetit të Konkurençës të Republikës së Kosovës